


# POSTA E MAQEDONISË SË VERIUT: BARRË APO PASURI SHTETËRORE?



# Hyrje

---



Tridhjetë vite pas ndarjes së Postës së Maqedonisë së Veriut (më tutje Posta e RMV) nga PTT e ish-Jugosllavisë, gjendja e Postës së RMV është ndër më të vështirat në 3 dekadat të ekzistencës së saj, ndërsa e ardhmja e saj mbetet e pasigurtë nën sinjalet e paqarta të Qeverisë dhe në vorbullën e akuzave dhe gjykimeve të qeveritarëve për keqpërdorim të detyrës në rastin e prokurimit të kompanisë që kreu studimin e fizibilitetit në përpjekjen për të përcaktuar të ardhmen e Postës së RMV.

Në njërin anë shpenzimet e larta dhe në rritje, të cilat vijnë kryesisht nga fuqia e madhe puntore e angazhuar në Postë, ndërsa në anën tjetër të hyrat gjithnjë e në rënie si pasojë e ndryshimeve në formën e komunikimit dhe transferimit të 'letrave', si dhe pamundësisë së Postës për të konkuruar në tregun e lirë në rritje, Posta e RMV viteve të fundit shënon humbje dhe borxhe rekorde që arrijnë shumën e mbi 3 milion 2.5 milion eurove respektive.

Kjo gjendje e rënduar financiare gjithnjë e më shumë rëndon taksapaguesit dhe buxhetin e shtetit, i cili vetëm në vitin 2022 subvencionoi Postën e RMV me mbi 1.9 milion euro. Kjo gjendje domosdoshmërisht ka bërë që të ngriten pyetje dhe dilema mbi të ardhmen e Postës së RMV, e biles edhe të shkohet përtej asaj. Në vitin 2020 Qeveria ndërmori iniciativë për të bërë studim fizibiliteti për të ardhmen e Postave të RMV, ndërsa mundësia e privatizimit shihej si zgjidhje e mundëshme për t'i dhënë fund problemeve të Postës.

Me qëllim të ndriçimit të disa aspekteve që lidhen me Postat e RMV, si dhe duke synuar të kontribuojmë në rritjen e cilësisë së debatit publik përmes të dhënave statistikore dhe historike, në këtë raport, Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike - IDEA ka grumbulluar dhe analizuar disa dimensione të veprimtarisë së Postës së RMV, duke filluar nga historiku i saj dhe zhvillimet e fundit, deri tek tregu postar dhe performanca financiare e Postës së RMV për periudhën 2015-2022.

Raporti nuk synon të jap zgjidhje për gjendjen dhe të ardhmen e Postës së RMV, meqë për atë qëllim do të duhej një analizë më e thellë dhe më sistematike. Synimi ynë mbetet ndriçimi i disa aspekteve të gjendjes aktuale të Postës së RMV me qëllim të ushqimit të debatit publik me të dhëna të sakta dhe lehtë të qasshme, dhe tërheqjen e vëmendjes së mediave, opinionit dhe institucioneve relevante në gjendjen aktuale dhe në përkeqësim e sipër të Postës së RMV.

Të dhënat e paraqitura në raport janë siguruar nga raportet zyrtare të Postës, Agjencisë për Posta dhe institucioneve tjera relevante, si dhe nga kërkesat për informacion me karakter publik të dërguara nga ekipi i Institutit IDEA gjatë javëve dhe muajve të kaluar.

**Tabela 1. Lista e drejtorëve të Postës: 1997-2023**

Emri, mbiemri	Periudha
Bujare Abazi	2023- vazhdon
Vasko Stefanov	2022- 2023
Jani Makraduli	2020- 2022
Ejup Rustemi	2018- 2022
Fadis Rexhepi	2014- 2018
Goce Bobolinski	2014- 2014
Rafiz Aliti	2011- 2014
Ejup Rustemi	2008- 2012
Sadula Idrizi	2006- 2008
Taip Jakupi	2002- 2006
Rauf Ramadani	2001- 2002
Etem Aziri	1999- 2001
Aco Gurçeski	1997- 1998

## Postat sot: e ardhme e pasigurtë e një “gjigandi”

---

Postat e Maqedonisë së Veriut më 12 korrik shënuan tridhjetë vjetorin e themelimit të tyre si Ndërmarrje Publike që kryen shërbime postare në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pas tridhjet vitesh ekzistencë, sot Postat RMV-së gjinden në një situatë relativisht të rëndë dhe me një të ardhme më të pasigurtë se kurrë.

Viteve të fundit Posta është duke përjetuar gjendje të rëndë financiare, dhe kjo mund të shihet në humbjet masive të cilat posta realizon në 7 vitet e fundit (më shumë në kapitullin 3). Për më tepër, si rrjedhojë e krizës që e pësoi Posta gjatë periudhës së pandemisë, me kolapsin e Euro Standard Bank, gjendja e Postës u vështirësua edhe më tepër duke shënuar ulje drastike të të hyrave dhe pamundësi për t'i mbuluar shpenzimet operative.

Si zgjidhje, në tetor të vitit 2020 Qeveria ndërmorri një iniciativë për të shqyrtuar opsionet dhe mundësitë e menaxhimit të mëtutjeshëm të Postës, duke aluduar në mundësinë e privatizimit të saj, me çka vedosi të ardhmen e Postës në një rrugë të pasigurtë dhe ngjalli shumë reagime në opinion. Qeveria e Maqedonisë së Veriut më 13 tetor të vitit 2020 deklaroi për mediat se:

*“Posta e Maqedonisë së Veriut është duke punuar me humbje. Për këtë arsye në diskutim është privatizimi i plotë i Postës së shtetit, ose partneriteti publiko-privat. Ndërsa, studimi i fizibilitetit duhet të bëhet në këtë rast dhe të vlerësohet mundësia për marrjen në partneritet publiko-privat ose privatizim i plotë për liberalizimin e shërbimeve postare sipas rregullativës së BE-së.” (1)*

Qeveria ende pa pasur në dorë faktet nga ndonjë studim sistematik i Postës, presupozoi që keq-menaxhimi ishte arsyeja e humbjeve të vazhdueshme. Zëvendës-Kryeministri për Çështje Ekonomike Fatmir Bytyqi në një deklaratë të dhënë me 20 tetor të vitit 2020 shprehet duke thënë që:

*“Për qytetarët, kjo do të thotë që në vend që të kenë një kompani publike që do të jetë fitimprurëse, e cila do t’u sigurojë atyre shërbime më cilësore, nga ana tjetër, ne shpenzuar paratë e tyre publike për të vendosur një humbës i cili me të vërtetë për shkak të paaftësisë për menaxhim nuk u tregua si model i mirë.” (2)*

Duke ndërmarrë hapa më konkret në drejtim të gjetjes së zgjidhjes afatëgjate, Qeveria angazhoi kompaninë **“Interholding”** për të zhvilluar një studim fizibiliteti me qëllim që të krijonte një pasqyrë të qartë të punës së Postës, ku analiza e sajë do të shërbente për hapat e mëtejshme për procesin e gjetjes së zgjidhjes për Postën. Megjithatë, edhe ky proces nuk kaloi lehtë. Në prill të vitit 2022 ish-Sekretari i Qeverisë Muhamed Zekiri arrestohet për dyshime të keqpërdorimit të detyrës në rastin procesit të prokurimit pa tender të kompanisë “Interholding”, me çka dyshohej që ka dëmtuar buxhetin e shtetit me një milion euro. (3)

Sidoqoftë, studimi i fizibilitetit përfundoi dhe kompania “Interholding” ka dërguar dokumentin përfundimtar tek Qeveria dhe Posta e RMV, megjithatë ai nuk është i qasshëm për publikun. Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike - IDEA ka dërguar kërkesa për informacion me karakter publik deri tek Postat si dhe Qeveria duke e kërkuar dokumentin e studimit të fizibilitetit, ndërsa nuk kemi marrë përgjigjen e kërkuar, vetëmse na është dhënë mundësia të shohim studimin por jo edhe të kemi një kopje për ta analizuar atë detajisht. Megjithatë, ajo çfarë dihet është vetëm ajo që është thënë nga Zëvendës-Kryeministri për Çështje Ekonomike z. Fatmir Bytyqi, i cili ka bërë ditur në deklarata të ndryshme që ai studim përmban analizë të gjendjes aktuale të Postës.

1. Maqedonia përgatit privatizimin e Postës shtetërore, Telegrafi, 14 Tetor, në dispozicion në, [“Telegrafi, https://telegrafi.com/maqedonia-pergatit-privatizimin-e-postes-shteterore/](https://telegrafi.com/maqedonia-pergatit-privatizimin-e-postes-shteterore/) (qasur më 18.09.2023)

2. RMV, Posta u dogj, e plaçkitën, askush nuk u përgjigj, kështu që do të shitet, Portalb, 20.10.2020, në dispozicion në, <https://arkiv.portalb.mk/713994-rmv-posta-u-dogj-e-plackiten-askush-nuk-u-pergjigj-keshtu-qe-do-te-shitet/>

3. <https://alsat.mk/muhamed-zeqiri-nga-paraburgimi-dergohet-ne-arrest-shtepiak/>

Po ashtu, sipas asaj që është thënë nga z. Bytyqi në procesin gjyqësor kundër Muhamed Zekirit, studimi i fizibilitetit përmban edhe rekomandime që brenda 5 viteve Postat të shndërrohen nga një ndërmarrje humbëse në ndërmarrje profitable, megjithatë nuk potencon cila është alternativa: privatizim, partneritet publiko-privat apo pronësia shtetërore. Deklarativisht z. Bytyqi ka bërë të ditur se ky studim do të shfrytëzohet në të ardhmen, por çështja ka ngecur ngaqë dy javë pasi është pranuar studimi është shkarkuar ish-drejtori i postës, z. Jani Makraduli (2020-2022), më pas në vend të tij, është emëruar z. Vasko Stefanov (2022-2023), si drejtor i ri, por edhe ky u shkarkua dhe pastaj u emërua drejtoresha e re dhe aktuale, z. Bujare Abazi.

Pra siç duket, teksa fundi i mandatit të kësaj Qeverie afrohet, ajo ende nuk e ka të qartë se cila do të jetë zgjidhja afatëgjate për Postën, ndërsa procesi i privatizimit mbetet ende proces i padefinuar përderisa Qeveria nuk ka ndërmarrur hapa konkret në drejtim të privatizimit. Në anën tjetër, përshtypja e udhëheqësisë aktuale të Postës është që studimi i fizibilitetit duhet të përdoret më shumë si një dokument konsultativ për përmirësimin e performancës së Postës, sesa një studim fizibiliteti për privatizimin e saj.

Sot Posta vazhdon me vështirësitë e saj financiare duke përfshirë së fundmi edhe problemin me pagat ndaj puntorëve.

## **Si funksionon Posta: çfarë thot Ligji për Shërbime Postare (LPSHP)?**

---

LPSHP në Republikën e Maqedonisë së Veriut përcakton rregullat dhe dispozitat që rregullojnë funksionimin e tregut postar dhe ofrimin e shërbimeve postare nga ofruesit e shërbimeve postare në vend. LPSHP përfshin dispozita për shërbimet postare universale, shërbimet postare të tregut të lirë, dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve postare nga personat fizik ose juridik. Gjithashtu Neni 2 i këtij LPSHP përcakton objektivat bazë të veprimtarisë postare në veçanti: Ofrimi i Shërbimeve Postare: LPSHP synon të rregullojë dhe lejojë ofrimin e shërbimeve postare në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i këtij sektori.

Neni 3 gjithashtu përcakton se çështjet e ofrimit të shërbimit universal, emetimin e pullave postare dhe vlerave postare, si dhe përcakton që ndërtimi, mirëmbajtja, zhvillimi dhe funksionimi i rrjetit postar janë çështje me interes publik. Pra veprimtaria postare sipas frymës së LPSHP duhet të ketë edhe mbikqyrjen e organeve shtetërore meqë është veprimtari me interes publik.

LPSHP rregullon organet kompetente për kryerjen e detyrave në fushën e shërbimeve postare dhe përgjegjëse janë:

1 Organi i Administratës Shtetërore

2 Agjencia Postare

### **Organi i Administratës Shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e shërbimeve postare (Organi i Administratës Shtetërore)**

Organi i Administratës Shtetërore, sipas Nenit 6 të LPSHP, është i ngarkuar me një sërë kompetencash që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e sektorit të shërbimeve postare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këto kompetenca përfshijnë *“zbatimin e politikave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në sferën e shërbimeve postare”*, përgatitjen e rregullores ligjore për veprimtarinë postare në bashkëpunim me Agjencinë e Postës, zhvillimin e strategjisë për shërbimet postare dhe prezantimin e saj për miratim para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, koordinimin dhe harmonizimin e veprimeve në sektorin postar, *“nxitjen e konkurrencës së shërbimeve postare”*, përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në organizata ndërkombëtare të fushës postare dhe trafikur postar, si dhe kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara me LPSHP.

## Agjencia Postare

Agjencia është organ i pavarur publik të cilin e themelon Parlamenti i Maqedonisë së Veriut. Agjencia themelohet si person juridik i pavarur dhe jofitimprurës. Puna e Agjencisë është publike, ndërsa Agjencia ka kompetenca të gjera dhe një fushëveprim të gjerë në sektorin postar. Për më tepër, Agjencia ndjek strategjinë për zhvillimin e shërbimeve postare në vend, duke përfshirë përpjekjet për të siguruar shërbim universal të vazhdueshëm, të rregullt dhe të pandërprerë. Agjencia punon për të siguruar që përdoruesit të kenë akses të barabartë në këtë shërbim në aspektet e zgjedhjes, çmimit dhe cilësisë së tij. Ajo gjithashtu ndihmon në nxitjen e aksesit në rrjetin postar dhe promovon konkurrencën në sektorin postar, duke synuar hapjen e tregut dhe krijimin e një tregu të vetëm të shërbimeve postare. Agjencia ka përgjegjësinë e respektimit të detyrimeve që dalin nga direktivat e Bashkimit Evropian dhe Aktet e Unionit Universal Postar.

LPSHP gjithashtu rregullon sektorin privat postar duke kërkuar që çdo person juridik ose fizik që ofron shërbime postare të ketë një Autorizim të Përgjithshëm nga Agjencia dhe të plotësojë kushtet minimale të përcaktuara me ligj.

Sipas LPSHP, Agjencia ka kompetencën të marrë vendime ndaj ofruesve të shërbimeve postare në rast të shkeljeve të Ligjit dhe rregulloreve të tij, përcaktuar me procesverbal. Në bazë të LPSHP, Agjencia është e obliguar gjithashtu të monitoroj cilësinë e shërbimit universal dhe ndërmarre masat e nevojshme për zbatimin e LPSHP. Për këtë, Agjencia realizon hulumtime të opinionit publik në baza vjetore, të cilat janë të qasshme në web faqen e Agjencisë.

Kështu, LPSHP i jep liri të veprimit sektorit privat në fushën postare, ndërsa Agjencia e Postave ka përgjegjësinë e monitorimit dhe sigurimit të shërbimit universal për qytetarët.

4. [https://ener.gov.mk/files/propisi\\_files/documents/142\\_%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D0%BE%D1%88%D1%82%D0%B5%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D1%83%D1%81%D0%BB%D1%83%D0%B3%D0%B8%20.pdf](https://ener.gov.mk/files/propisi_files/documents/142_%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D0%BE%D1%88%D1%82%D0%B5%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D1%83%D1%81%D0%BB%D1%83%D0%B3%D0%B8%20.pdf)

5. [https://ener.gov.mk/files/propisi\\_files/documents/142\\_%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D0%BE%D1%88%D1%82%D0%B5%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D1%83%D1%81%D0%BB%D1%83%D0%B3%D0%B8%20.pdf](https://ener.gov.mk/files/propisi_files/documents/142_%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D0%BE%D1%88%D1%82%D0%B5%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D1%83%D1%81%D0%BB%D1%83%D0%B3%D0%B8%20.pdf)



## Tregu postar

---

Fushëveprimi i tregut postar arrihet me ofrimin e shërbimeve postare që përfshijnë marrjen, transferimin, renditjen dhe dërgimin e dërgesave postare nga ofruesit e shërbimeve postare në trafikun postar të brendshëm dhe ndërkombëtar.

### Shërbimet univerzale

---

LPSHP parasheh atë që njihet si **‘shërbim univerzal’**, që sipas Nenit 3 të LPSHP nënkupton *‘një vëllim minimal i shërbimeve postare që ofrohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me cilësi të caktuar dhe me çmime të përballueshme për përdoruesit e shërbimit.’* Me këtë sigurohet qasje për të gjithë qytetarët në disa kategori dergesash, siç janë letrat deri në peshë prej 2 kg, paketat deri në peshë prej 20 kg, shërbimet për personat e verbër dhe me shikim të pjesshëm të dëmtuar, etj. Sipas Nenit 4 të LPSHP, Posta e RMV është ofruesi univerzal i shërbimeve postare, pra Posta e Maqedonisë së Veriut është e detyruar që t’u sigurojë qasje në shërbime postare të gjithë qytetarëve të Maqedonisë së Veriut pamvarësisht vendbanimit të tyre në Maqedoninë e Veriut.

Kualitetin e shërbimeve univerzale sipas Nenit 28 të LPSHP e bën Agjencia për Posta, ndërsa në rast se shpenzimet gjatë ofrimit të shërbimeve univerzale janë më të larta sesa të hyrat, atëherë Agjencia për Posta mbulon dallimin që paraqitet (Neni 30) me të hyrat që ajo i realizon duke “taksuar” ofruesit e shërbimeve postare në vlerë prej 1.1% deri në 2% të të hyrave të tyre totale të realizuara nga ofrimi i shërbimeve postare. Pra, Posta është e mbrojtur ligjrisht nga humbjet financiare në ofrimin e shërbimeve univerzale postare.

### Shërbimet e Rezervuara Postare (ShRP)

---

Shërbimet e Rezervuara Postare (ShRP) janë një element i rëndësishëm në tregun postar dhe në veprimtarinë e Postës. Sipas Pikës 1 të Nenit 31 të LPSHP *“Shërbimet e Rezervuara Postare janë shërbime postare të cilat i ofron vetëm ofruesi i Shërbimeve Univerzale Postare”*, me kusht që ata të jenë me peshë maksimale deri në 50 gr. Në ShRP bën pjesë edhe Posta Direkte, që përfshinë materialet reklamuese, të marketingut apo propagandistike shpërndahen zakonisht në vëllime të mëdha.

Me fjalë të tjera, Posta ka **monopol** në shpërndarjen e letrave me peshë deri në 50 gr., ndërsa ky monopol është i përcaktuar në kohë. Afati i monopolit të Postës është i përcaktuar me LPSHP dhe ndryshimi i fundit i Ligjit ka ndodhur me 26 tetor të vitit 2020, ku me Nenin 4 pika (1) taksativisht thuhet: *“Ofruesi i shërbimit universal nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka të drejtë ekskluzive të ofrojë shërbime postare të rezervuara deri më 31 dhjetor 2023.”* (Gazeta Zyrtare, Nr. 227/2022).

Po ashtu, LPSH përcakton edhe çmimin e shërbimeve të rezervuara, ku Neni 41-a, pika 1 e propozim ndryshimeve të fundit thot: *“Ofruesit janë të obliguar që shërbimet e rezervuara postare t'i sigurojnë me çmim së paku dy herë e gjysmë më të lartë se çmimi me të cilin ofruesi i shërbimit universal i siguron dërgesat korresponduese të kategorisë standarde në shkallën e parë të peshës.”* Sipas ligjit, në këtë kategori hyn edhe shërbimi për postën direkte. **Në vitin 2022 ShRP përbënin rreth 20,091,400 dërgesa, apo 71.10% e vëllimit të tërësishëm të qarkullimit të Postës së RMV.**

## Tregu privat postar


Në Maqedoninë e Veriut tregu postar është i qasshëm edhe për ofruesit privat të shërbimeve postare në sferat e shpërndarjes së dërgesave që nuk bien në fushën e “rezervuar” për Postën e RMV. LPSHP parasheh kushte (Neni 29, 30, 31 dhe 33), që shërbimet postare të sigurohen nga ana e gjithsecilit që shfaq interesim qoftë person fizik apo juridik, të cilët do të dërgojnë njoftim deri te Agjencia për Posta, e të ciët i plotësojnë kushtet minimale të parashikuara me rregullativën ligjore.

Numri i ofruesve të shërbimeve postare, në tregun e lirë postar vazhdimisht ndryshon; paraqiten ofrues të rinjë por edhe ka prej atyre që e lëshojnë tregun. Megjithatë sipas raportit vjetor të Agjencisë për Posta, (6) në vitin 2022 figurojnë gjithsej 46 ofrues të shërbimeve postare, 9 prej të cilave ofrojnë shërbime në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut dhe ndërkombëtarë, 16 ofrojnë shërbime postare vetëm në Maqedoninë e Veriut, 12 në qytetin e Shkupit, dhe 10 nëpër qytetet tjera.

6. [https://ap.mk/sites/default/files/2023-](https://ap.mk/sites/default/files/2023-09/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D%20%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88%20%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%90%D0%B3%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D0%BE%D1%88%D1%82%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%202022.pdf)

[09/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D%20%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88%20%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%90%D0%B3%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D0%BE%D1%88%D1%82%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%202022.pdf](https://ap.mk/sites/default/files/2023-09/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D%20%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88%20%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%90%D0%B3%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BF%D0%BE%D1%88%D1%82%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%202022.pdf)


**Figura 1. Ofruesit e shërbimeve postare në tregun e lirë, 2016-2022**



Në pajtim me rregulloren për llojet e të dhënave financiare dhe informacioneve, të lidhura me sigurimin e shërbimeve postare dhe ndryshimin e raportit të sigurimit të shërbimeve postare, ofruesit e shërbimeve postare kanë detyrim ligjor për sjelljen e plotë të raportit deri te Agjencia për Posta, çdo gjashtë muaj, respektivisht dy herë në vit.

Sipas raportit vjetor të Agjencisë për Postat, numri i të punësuarve në sektorin postar në vitin 2022 ka qenë 3121, prej të cilëve 1998 të punësuar në Postat e Maqedonisë ndërsa 1,123 në sektorin privat. Figura 2 tregon një trend në rritje të numrit të të punësuarve në sektorin privat (pra prej 589 të punësuarve apo 110%), ndërsa numri i të punësuarve në Postat e Maqedonisë mbetet pothuajse i pandrëshueshëm nga ai i vitit 2015.

**Figura 2. Numri i puntorëve në sektorin postar: tregu i lirë vs Posta e Maqedonisë**



## Ndarja e tregut ("market share")

Tregu postar në vitin 2022 kishte qarkullim prej 35,826,592 dërgesa të kategorive të ndryshme. Prej tyre, 78.87%, apo 28,256,214 janë kryer nga Postat e RMV, ndërsa 7,570,378 apo 21.13% nga sektori privat postar. (7)

Në shikim të parë duket që Postat e RMV kanë një domimancë të tregut postar kundrejt atij privat, megjithatë tregu postar në të cilin operon Posta e RMV bie në kategorinë e shërbimeve univerzale (98.65% e dërgesave - shërbime univerzale) dhe atyre të rezervuara me ligj (rreth 20,091,400 dërgesa, apo 71.10% e vëllimit të tërësishëm), që nënkupton dy gjëra:

1. E para, Posta e RMV operon në fushëveprim ku gëzon defakto monopol të siguar me LPSHP dhe nuk është në konkurrencë të drejtpërdrejtë me sektorin privat, dhe
2. Në fushëveprimin e Postës së RMV, ekziston vërtetë vëllim i lartë i dërgesave, mirëpo ato janë me peshë të ulët dhe si rezultat edhe të hyra të ulta.


**Tabela 2.**

	Postat e RMV	Postat private	Total
Vëllimi i qarkullimit të dërgesave postare, 2022	28,256,214	7,570,378	35,826,592
Në përqindje	78.87%	21.13%	100.00%

## Të hyrat e industrisë postare

Në anën tjetër, krahasimi i të hyrave të Postës së RMV me të hyrat e ndërmarrjeve private në industrinë postare japin një pasqyrë krejtësisht tjetër mbi performancën e Postës së RMV. Siç mund të shihet edhe në Figurën 3, të hyrat e e industrisë postare arrijnë vlerën e mbi 42 milion eurove, ndërsa vërehet një disbalanc të aspekt të të hyrave të Postës së RMV kundrejt të hyrave të sektorit privat në proporcion me numrin e dërgesave të bartura. Pra, edhe pse Posta e RMV kryen 78.87% të dërgesave postare, ajo ka realizuar vetëm 46.03% të të hyrave në industrinë postare. Në anën tjetër, të hyrat e Postës së RMV kanë shënuar rënie të vazhdueshme, nga 23,486,008 euro në vitin 2016 në 19,459,852 euro në vitin 2022; ndërsa të hyrat e sektorit privat kanë shënuar rritje nga 8,238,482 euro në vitin 2016 në 22,818,980 euro në vitin 2022.

**Figura 3. Të hyrat Postës së RMV vs postave private, 2016-2022**



**Tabela 3.**

Viti	Të hyrat e Postës së RMV nga totali i të hyrave
2016	74.03%
2017	62.09%
2018	66.49%
2019	57.19%
2020	51.42%
2021	44.53%
2022	46.03%


## Qarkullimi i paketave: potencial i humbur dhe tregues i ineffiçencës?

Një fushë e rëndësishme e qarkullimit postar dhe me potencial të jashtëzakonshëm që ka ndikuar konsiderueshëm në rritjen numrit të kompanive në sektorin privat si dhe rritjen e të hyrave të sektorit privat dhe është vëllimi i qarkullimit të paketave, e cila ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së tregtisë digjitale, apo e-commerce.

Siç mund të shihet në Figura 4, vëllimi i qarkullimit të paketave ka shënuar rritje të vazhdueshme nga viti 2016 deri në vitin 2022. Nëse në vitin 2016 kanë qarkulluar gjithsej 1,080,612 paketa, në vitin 2022 ky numër ka arritur në 5,906,846 paketa, apo një rritje eksponenciale prej 446.62%.

Sipas llogarive të Institutit IDEA, vlera totale e tregut të shkëmbimit të paketave sillet nga 7 eri në 76 milion euro në vit, apo mesatarisht 20 milion euro, (8) ndërsa Posta e RMV ka arritur të ketë vetëm 2.39% të këtij tregu i cili ka potencial të jashtëzakonshëm financiar dhe është në rritje të vazhdueshme. Në këtë fushëveprim, Posta e RMV është në konkurrencë direkte me kompanitë private postare, dhe siç duket njerëzit dhe kompanitë që bëjnë shkëmbimin e paketave zgjedhin kompanitë private për të bërë dërgesat e tyre.

**Figura 4.** Qarkullimi i paketave, Posta e RMV vs postat private, 2016-2022




# PERFORMANCA FINANCIARE E POSTAVE TË MAQEDONISË

Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike - IDEA ka bërë përmbledhjen dhe analizën e raporteve financiare dhe raporteve të auditorit për Postat e Maqedonisë nga viti 2015 deri në vitin 2022. Raportet janë nxjerrur nga web faqja e Postës së RMV si dhe institucioneve tjera relevante, ndërsa një pjesë e raporteve të cilat nuk janë publike në web faqet e institucioneve përkatëse janë siguruar përmes kërkesave për qasje në informacion me karakter publik të dërguara nga data 12 prill deri me datë 1 shtator 2023. Pra, korniza e analizës tonë përmbledh gjithsej 7 vite të operimit të Postës (2015-2022).

## Të hyrat e Postës së RMV

Të hyrat totale të Postave të Maqedonisë janë relativisht të larta. Siç shihet në Figura 5. në vitin 2022 të hyrat e përgjithshme të Postës kanë qenë 19,504,904 euro, një rritje prej 6.31% nga viti 2021, ndërsa ulje prej -12.73% në krahasim me vitin 2015. Figura 5. tregon trendin rënës të të hyrave të përgjithshme të Postës së RMV.

**Figura 5.** Gjithsej të hyra të Postës së RMV (EUR), 2015 - 2022



Për të dhënë sado pak një shpjegim mbi arsyet e rënies së të hyrave të Postës, në vijim do të analizojmë strukturën e të hyrave të Postës së RMV dhe të hyrat sipas kategorive ndër viteve.


## Struktura e të hyrave të Postës së RMV

Struktura e të hyrave të Postës është si vijon:

- Të hyrat nga shërbimet postare
- Të hyrat nga shërbimet financiare
- Të hyrat nga posta hibride
- Të hyra tjera

Në aspekt të proporcionit të këtyre të hyrave për vitin 2022, siç mund të shihet nga Figura 6, të hyrat më të mëdha (apo 73% e të hyrave) vijnë nga shërbimet postare të cilat Posta i kryen, ndërsa më të voglat janë ato nga shërbimet hibride me vetëm 0.6% të të hyrave të përgjithshme.

**Figura 6. Struktura e të hyrave të Postës së Maqedonisë, 2022**



Ky proporcion ka qendruar relativisht i pandryshuar në pjesën dërrmuese të të hyrave, me përjashtim të të hyrave nga shërbimet financiare të cilat pothuajse janë përgjysmuar, duke shkuar nga 5,041,626 euro në vitin 2015 në 2,482,646 në vitin 2022 (apo nga 21.3% në 12.7% të të hyrave të përgjithshme).




Para se të analizojmë se çfarë ka ndikuar në rënien e të hyrave të përgjithshme, duhet të shohim cilat nga kategoritë e të hyrave kanë pësuar rënie apo ngritje dhe sa është shuma apo proporcioni i tyre.

Pra, siç shihet në Figurën 6 më lartë, **95%** të të hyrave në vitin 2015 Posta i ka realizuar vetëm nga dy kategori të të hyrave: **të hyrat nga shërbimet postare** dhe të hyrat nga **shërbimet financiare**. Prandaj këto dy kategori meritojnë analizë më të detajuar.

## Të hyrat nga Shërbimet Postare

Siç mund të shihet në Figurën 7, të hyrat nga shërbimet postare kanë shënuar trend rënës nga viti 2015, duke përjetuar rënien më të madhe në vitin 2020 gjatë kohës së pandemisë me -20.10% rënie në krahasim me vitin 2015. Megjithatë, pas pandemisë, në vitin 2021 të hyrat u ngritën për 3.26% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2022 përsëri pësuar rënie për -1.45% në krahasim me vitin 2021 dhe -18.70% në krahasim me vitin 2015.

**Figura 7. Të hyrat nga Shërbimet Postare (EURO), 2015-2022**



Të hyrat nga Shërbimet Postare që Posta i kryen ndahen në këto kategori:


- Shërbime për bartjen e letrave
- Shërbime për bartjen e paketave
- EMS - Posta e Shpejt
- Bartja e gazetave dhe letrave tjera të shtypura

Ashtu siç mund të shihet në Figurën 8, të hyrat nga Shërbimet për Bartjen e Letrave janë pjesa dërmuese e të hyrave në kategorinë e të hyrave nga Shërbimet Postare, apo gjithsej 94.7% e të hyrave nga Shërbimet Postare. Siç mund edhe të supozohet, bartja e letrave apo dërgesave me peshë deri në 50 gram është e drejtë ekskluzive e Postës së RMV dhe kryhet me çmim dy herë e gjysëm më të madh sesa çmimi normal.


Të gjitha kategoritë e të hyrave në kategorinë e Shërbimeve Postare kanë përjetuar rënie, megjithatë të hyrat nga Shërbimet për Bartjen e Letrave kanë shënuar rënien më të madhe, edhe atë prej 3,037,969 eurove apo 18.40% krahasuar me vitin 2015.

**Figura 8.**

**Të hyrat nga Shërbimet Postare sipas kategorisë: 2022**



**Figura 9. Të hyrat nga Shërbimet Postare sipas kategorisë (EURO), 2015 dhe 2022**




Edhe pse nuk ekziston ndonjë studim i mirëfilltë rreth arsyeve të zvogëlimit të të të hyrave nga Bartja e Letrave, disa nga arsyet mund të jenë:

- **Ndryshimi i mënyrës së komunikimit:** teknologjia digjitale ka transformuar formën e komunikimit dhe dërgesës së fakturave të ndryshme, prandaj edhe kërkesa për shërbimet e Postës së RMV natyrshëm ka rënë;
- **Efiçenca e bartjes së dërgesave:** problemet me dërgimin në kohë dhe në vendin e paracaktuar, me çka subjektet hezitojnë të bëjnë transferin e letrave përmes Postës, po ashtu mund të jenë ndër arsyet e zvogëlimit të vëllimit të letrave që qarkullojnë.

## Të hyrat nga Shërbimet Financiare

Shërbimet financiare të cilat Posta ofron për qytetarët nëpër sportelet e saj, siç janë pagesat e faturave për energji elektrike, pagesat e pensioneve, pagesat e ndihmave sociale, etj., përbëjnë 12.7% të të hyrave të përgjithshme të Postës, pra kategoria e dytë më e madhe e të hyrave që realizon Posta e RMV. Megjithatë, ky nivel i të hyrave nga Shërbimet Financiare nuk ka qenë gjithmonë kështu. Kjo kategori e të hyrave po ashtu ka shënuar zvogëlim të konsiderueshëm ndër vite. Siç mund të shihet në Figurën 10, të hyrat nga shërbimet financiare në vitin 2015 ishin 5,041,626 dhe përbënin 21.31% të të hyrave të përgjithshme, ndërsa në vitin 2023 ato ranë në 2,482,646 euro apo 12.73% nga totali i të hyrave, duke shënuar një rënie prej 2,558,980 eurove.

**Figura 10. Të hyrat nga Shërbimet Financiare (EURO)**



Të hyrat financiare përbëhen nga 4 kategori të ndryshme:

- Pagesa e kompenzimeve të ndryshme (penzione dhe të ndryshme)
- Transaksione të pagesave dhe shërbimet bankare
- Provizione nga pagesa e faturave
- Porositë postare

Janë disa faktorë që kanë ndikuar në rënien e të hyrave të Postës nga Shërbimet Financiare, edhe atë:


- Liberalizimi i tregut financiar dhe shtimi i bankave komerciale të cilat u japin akses qytetarëve të kryejnë shërbime nëpër banka
- Një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në uljen e të hyrave financiare të Postës është edhe ndërprerja e funksionimit të Euro Standard Bankës në vitin 2020. Më saktësisht, në gusht të vitit 2020 Posta ndalon ofrimin e shërbimeve financiare sepse ESB-së, partnerit të Postës i cili i mundësonte Postës kryerjen e shërbimeve financiare dhe shërbime të qarkullimit pagesor, i hiqet e licenca e operimit dhe hapet procedurë falimentimi, që sipas Bankës Qendrore, u bënë sepse “ESB nuk respektonte kërkesat minimale për funksionim të një banke”. Kjo përveçse krijoi kaos para bankave meqë qytetarët nuk mund të paguanin faturat e tyre në sportelet e Postës, shkaktoi edhe humbje të mëdha për Postën, (9) e që sipas drejtorit të atëheshëm të Postës, Ejup Rustemi, Posta do të humbiste përafërsisht 110 milionë denarë (1,788,617 euro) nga shërbimet që nuk do të mundë t’i kryente më.

Në fakt, analiza jonë tregon që Posta në vitin 2020, viti kur ESB ndaloi funksionimin, Posta realizoi 1,411,957 më pak të hyra nga shërbimet financiare krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2021 2,036,187 euro më pak se në vitin 2019. Pra në total, humbjet nga falimentimi i ESB mund të llogariten të ken tejkaluar 3 milion euro.

## Konkluzion

Siç mund të shihet në Figurën 11, shumica e kategorive të të hyrave kanë pësuar rënie, ndërsa më eklatantet dhe me më ndikim janë rënia e të hyrave nga shërbimet postare prej mbi 3 milion eurove (apo -18.70%) dhe ato nga Shërbimet Financiare prej më shumë se 2.5 milion eurove, apo -50.76% krahasuar me vitin 2015. Rritje prej pothuajse 2 milion eurosh kanë shënuar “Të hyrave tjera”, të cilat në raportet financiare të Postës janë të pa deshifrueshme.


**Figura 11. Dallimi në të hyra sipas kategorisë (EURO), 2015-2022**



## Shpenzimet e Postës

Posta e RMV dukshëm bën shpenzime të mëdhaja operative të cilat reflektohen në raportet financiare dhe kanë ndikim të madh në profitabilitetin e saj. Shpenzimet e tërësishme të Postës në vitin 2022 kanë arritur rekord të fundit me 23,242,832 euro, e cila është një rritje prej 9.17% krahasuar me vitin 2021 dhe 4.61% me vitin 2015. Në shumë absolute i bie që Posta në vitin 2022 ka 1,023,320 euro shpenzime më shumë se në vitin 2015.

**Figura 12. Trendi i shpenzimeve të Postës (EURO), 2015-2022**




## Struktura e shpenzimeve të Postës

Posta ka 5 lloje të shpenzimeve: Kostoja e lëndëve të para, Materialeve dhe Vlera e Blerjes, Shpenzime për Shërbime, Amortizim, Paga si dhe Shpenzime tjera. Sipas proporcionit, shpenzimet më të mëdhaja të Postës janë për Paga, të cilat përbëjnë 64% e shpenzimeve totale, proporcion ky që ka mbetur kryesisht i pandryshuar në krahasim me vitin 2014.

Figura 13.

## Të dalurat sipas proporcionit, 2022




## Shpenzimet për paga

Meqë shpenzimet për paga përbëjnë pjesën dërmuese të shpenzimeve totale (64%), ndryshimet apo mos ndryshimet në shumën totale të pagave ndjeshëm ndikon në totalin e shpenzimeve të postës.

Edhe pse numri i të punësuarve në Postë ka rënë për 11.79%, shpenzimet për resurse njerëzore nuk kanë rënë, përkundrazi ato janë rritur, e që mund të jetë pasojë e rritjes së pagave. Në krahasim me vitin 2015, shpenzimet për resurse njerëzore janë rritur për 2.87%, apo për 412,616 euro. Trendi i shpenzimeve për Paga mund të shihet në Figurën 14 më poshtë.


Figura 14. Shpenzimet për paga (euro): 2015-2022



Një element interesat që paraqitet në raportet e auditorit janë postierët të punësuar me kontratë dhe kontratat në vepër. Raportet financiare dhe ato të auditorit tregojnë që shpenzimet e përgjithshme për këto dy kategori kanë arritur shumën prej 365,178 eurove në vitin 2022, apo një rritje prej 155.12% nga viti 2021.

Nga një përlogaritje e thjeshtë, del që Posta e RMV ka të angazhuar diku 619 persona me kontrata në vepër (sipas pagës mesatare), apo nga 8 në secilën prej 80 komunave në Maqedoninë e Veriut. Është e paqartë nëse angazhili i këtij numri të të punësuarve me kontrata në vepër, përskaj 1,998 të punësuarve të tjerë, është domosdoshmëri apo është thjeshtë bljerje e influencës tek ata të punësuar për arsye elektorale apo tjera.

**Figura 15. Shpenzimet për postier me kontratë dhe kontratat në vepër (euro), 2021 & 2022**




## Konkluzion

Siç shihet në Figurën 16 më poshtë, rritje të nivelit të shpenzimeve kemi në kategorinë e shpenzimeve për lëndë të para dhe materiale, në paga dhe në shpenzimet tjera, ndërsa ulje kemi në Amortizim dhe në Shërbime. Shpenzimet për Amortizim duket të jenë të zvogëluara si pasojë e faktorëve të ndryshëm, duke filluar nga ulja e vlerës së pronave të Postës për të balancuar humbjet e vazhdueshme, po ashtu edhe nga mos amortizimi i mëtejshëm i aseteve të cilat kanë kaluar afatin e amortizimit.



Një ndër hapat e parë që do të duhej të ndërmerren për rritjen e profitabilitetit të Postës së RMV është zvogëlimi i shpenzimeve, e në këtë drejtim do të duhej të shikohen shpenzimet të cilat nuk krijojnë vlerë të shtuar në ndërmarrje apo thënë ndryshe shpenzimet jo-produktive.

**Figura 16. Përqindja e rritjes/zvogëlimit të shpenzimeve sipas kategorisë: 2014-2022**



**Tabela 4.**


	Dallimi në shpenzime, 2015-2022
Kostoja e lëndëve të para, materialeve dhe vlera e blerjes	+904,742.00
Shërbime	-637,017.00
Amortizim	-215,878.00
Paga	+412,675.00
Shpenzime tjera	+558,797.00

Sidoqoftë, shpenzimet të cilat kanë ndikim të dukshëm në shpenzimet e tërësishme janë pagat, të cilat nga viti 2015 kanë shënuar rritje prej 2.87%% apo 412,675 euro, dhe çdo tentativë për zvogëlim të shpenzimeve të përgjithshme do të duhej të shikonte më thellë në shpenzimet për Paga.

## Fitimi/humbja


Si pasojë e të hyrave të tkurrura dhe shpenzimeve të rritura gjatë shtatë viteve të fundit, Postat e RMV që nga viti 2017 veprojnë në humbje relativisht të thellë. Për shembull, në vitin 2021 dhe në vitin 2022, humbjet totale të Postës kanë qenë 2,858,601 dhe 3,832,669 euro, edhe përkundër të hyrave relativisht të larta që Posta ka pasur.

**Figura 17. Fitimi/humbjet e Postave të RMV (EURO), 2015-2022**




## Subvencionet nga ana e Qeverisë

Si pasojë e humbjeve dhe likuiditetit të dobët, Posta e RMV gjatë viteve të fundit është në mvarshmëri të vazhdueshme nga subvencionet dhe donacionet e Qeverisë dhe institucioneve tjera. Vetëm në tre vitet e fundit Qeveria e RMV ka dhënë 5,235,772 euro subjencione Postës në mënyrë që të sigurohet veprimtari e saj. Figura X më poshtë paraqet nivelin e subvencioneve që Qeveria i ka ndarë Postës së RMV në tre vitet e fundit.

**Figura 18. Subvencionet që Posta ka marrur nga Qeveria: 2020-2022**

## Borxhet e Postës

Si pasojë e humbjeve të vazhdueshme ndër vite, borxhet e Postave të RMV kanë pësuar rritje të vazhdueshme ndër vite, edhe atë për 1,869,724 euro, apo 460% nga niveli i vitit 2016. Figura 19 më poshtë tregon trendin rritës të borxheve të cilat në vitin 2022 ka arritur në 2,275,496 euro (prej të cilave 650,407 euro borxhe afat-shkurta).

**Figura 19. Borxhet e Postave të Maqedonisë (euro), 2016-2022**

## Përfundim

---

Ashtu siç mund të shihet nga të dhënat e paraqitura në analizën tonë, Posta nuk është në ditët e saja më të mira. Përkundrazi, vështirësitë e saj financiare duket që thellohen ditë e më shumë, ndërsa ende mbetet e paqartë se si do të jetë fati i Postës së RMV në vitet në vijim.

Nga shqyrtimi i të dhënave të performancës së Postës, disa nga rekomandimet modeste të Institutit për Demokraci dhe Analiza Ekonomike - IDEA mund të jenë:

- Në afat të shkurtër menaxhmenti i Postës duhet të shkurtojë kostot jo produktive të cilat nuk shtojnë vlerë në veprimtarinë e Postës, në mënyrë që të zvogëlohen humbjet dhe Posta të jetë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative.
- Posta e RMV duhet të t'i vendosë në përdorim kapacitetet njerëzore dhe të garojë me kompanitë private për tregun e qarkullimit të Paketave.
- Posta e RMV duhet të fokusohet në rritjen e cilësisë së shërbimeve, edhe atë duke përmirësuar ato aspekte të cilat janë të rëndësishme për konsumatorët. Për shembull, 79% e konsumatorëve në anketën e fundit kanë theksuar që për ta më e rëndësishme është shpejtësia e shpërndarjes së porosive, prandaj edhe Posta duhet të fokusohet në rritjen e efikasitetit të shpërndarjes.
- Posta duhet të targetojë personat juridik, respektivisht ndërmarrjet private, dhe të përmirësojë efikasitetin e shërbimeve ndaj tyre, meqë vetëm 19% të të anketuarve nga personat juridik shprehen shumë të kënaqur me shërbimet e Postës, ndërsa një pjesë e madhe e tyre përdorin vetëm shërbimet financiare të cilat Posta ofron.
- Posta po ashtu duhet ta rrisë vizibilitetin e saj dhe t'i informojë konsumatorët mbi shërbimet që ajo ofron, respektivisht sa i përket dërgesave më të mëdha. Statistikat nga raporti i fundit flasin që 83% e të anketuarve nuk e dijnë që ekzistojnë kuti ku mund të vendosin apo të marrin porositë e paketave, e cila mund të jetë faktor për mos përdorimin e shërbimeve të Postës së RMV.



Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike – IDEA është “think tank” i krijuar në mars të vitit 2023 në Shkup, me mbështetjen e European Endowment for Democracy.

Në esencë, ne besojmë se forca e demokracisë tonë dhe cilësia e politikave ekonomike janë ngushtë të lidhura me angazhimin dhe pjesëmarrjen tonë demokratike. Ky besim i palëkundur ushqen qëllimin tonë, si ekip i përkushtuar për të kontribuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të demokracisë dhe politikave ekonomike në Maqedoninë e Veriut.

Ne e përfytyrojmë Maqedoninë e Veriut si një shtet anëtar progresiv, liberal dhe rezilient i Bashkimit Evropian i cili është i ndërtuar mbi gjithëpërfshirje, inovacion dhe qëndrueshmëri. Ne jemi këtu për ta avancuar demokracinë dhe për të nxitur zhvillimin!

[www.idea.org.mk](http://www.idea.org.mk)

Tetovska 33/2/7 , Skopje, Republic of Macedonia

+389 70 985 729

